



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:269044

Datë: 07.08.2024

Numri i dokumentit: 06027722

C.nr.4391/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.A. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. S.M.N. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, të cilën e përfaqëson A.A. me objekt kontesti kompensimi i inflacionit, vlera e kontestit 608.48 euro, me datë 07.08.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.A. nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, që paditësit t’ia kompensoj në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01.01.2021 – 31.12.2021, në shumën prej 157.41 euro.
2. Për periudhën kohore 01.01.2022 – 31.10.2022, në shumën prej 451.07 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 608.48 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 01.12.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi B.A. nga Prizreni, përmes të autorizuarës së tij av. S.M.N. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 01.12.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, të cilën e përfaqëson Atila Arzuallxhiu, me objekt kontesti kompensimi i inflacionit.

Në referatin e padisë ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune pranë SH.F.M.U. “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit, mësimdhënëse dhe atë në bazë të kontratave të punës. Në vazhdim ka theksuar se paditësi në bazë të vërtetimit të lëshuar nga drejtoria e shkollës SH.F.M.U. “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit me nr.183/23, datë 10.11.2023, pranë këtij institucioni është i punësuar në cilësi të mësimdhënësit përgjat viteve 2021 dhe 2022. Paditësi sipas kontratës në vitin 2021 ka realizuar pagën mujore

neto prej 390.42 euro, në vitin 2022 ka realizuar pagën neto 392.24 euro. Ka theksuar se shkalla e inflacionit në vitin 2020 ka qenë 0.2%, në vitin 2021 mesatarja e inflacionit ka qenë 3.6% ndërsa në vitin 2022 mesatarja e inflacionit në vend ka qenë 11.5%. Bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë, mirëpo e paditura këtë kompensim nuk i ka paguar paditësit deri më tani, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit si e bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë 104 euro për padi dhe 20 euro për taksën gjyqësore.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit të saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Në bazë të njoftimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nr.01B/ të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021 padia dhe kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar Pretendimet e paditësit se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padija është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditësit nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditësit se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Në fund, gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga kontrata e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 164/22, e datës 13.10.2022, për paditësin e lëshuar nga e paditura, vërtetohet fakti se paditësi ka krijuar marrëdhënie pune me të paditurën, në SH.F.M.U. “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Zym, Komuna e Prizrenit, si mësimdhënës. Nga vërtetimi me numër të referencës 183/23, e datës 10.11.2023, vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune në SH.F.M.U. “Shtjefën Gjeçovi” në fshatin Zym, gjatë vitit shkollor 2020, 2021, 2022.

Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet që lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së

Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2021 ka qenë 3.6% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi Gjykata llogaritjen e kompensimit mbi bazën e inflacionit e ka llogaritur sipas pagës bazë prej 390.42 euro për vitin 2021 dhe sipas pagës prej 392.24 euro për vitin 2022 dhe jo sipas pagës bazë të paditësit në shumën prej 421.00 euro, pasi që kërkesa e paditësit ka qenë e llogaritur sipas kësaj shume, andaj edhe përllogaritja është bërë në këtë mënyrë.

Duke marrë për bazë se gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së vendos brenda kërkesës së palëve ndërgjyqëse, mbi këtë bazë gjykata aprovoi këtë kërkesë të palës paditëse.

- Për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses e theksuar në kërkesëpadi është 390.42 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 157.41 euro ($390.42 \times 3.6\% = 14.05 \times 12 \text{ muaj} = 157.41 \text{ euro}$), përkundër faktit se shuma e kalkuluar për këtë vit rezulton të jetë në lartësi prej 168.60 euro.
- Për periudhën 01.01.2022 – 31.10.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.5%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses e theksuar në kërkesëpadi është 392.24 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 451.07 euro ($392.24 \times 11.5\% = 45.10 \times 10 \text{ muaj} = 451.07 \text{ euro}$).

Pra, gjykata ka vendosur si në pikën nën II. të dispozitivit të aktgjykimit, bazuar në dispozitën ligjore të theksuar më lartë, për faktin se gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera

për dhënien e tij”. ”, andaj ka vendosur si në pikën nën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (01.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohej kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.4391/2023, datë 07.08.2024

Gjyqtar
i,
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.